

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(të shoqërisë "DAKZ" sh.p.k.)

Sot, më datë 14.04.2024, prane zyres se shoqërisë **DAKZ** shpk, , u paraqit personalisht:

PALA SHITËSE:

- Z. Sotir Veshaj, lindur ne Lepenice , i datelindjes 12.07.1982, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar , me numer identifikimi te ID I20712050L.
- Z. Pandeli Veshaj , lindur ne Lepenice , i datelindjes 17.08.1973, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar , me numer identifikimi te ID H30817037M.
- Zgjimi Caushaj lindur ne Vlore , i datelindjes 08.11.1991, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar , me numer identifikimi te ID J11108065W.

(të cilët këtu dhe në vijim në këtë kontratë do të quhen "**Shitësi**".)

PALA BLERËSE:

- Z. BERNARD CAUSHAJ, lindur ne Lushnje , i datelindjes 24.10.1961, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar , me numer identifikimi te ID G11024036O
- (i cili këtu dhe në vijim në këtë kontratë do të quhet "**Blerësi**".)

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Neni 1. -Të dhënat e pasurisë objekt shitblerje:

-Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se prane Autoritetit shqiptar "Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), rezulton e regjistruar Shoqëria e emërtuar "DAKZ" Shpk, me seli ligjore në adresën Lagjia Rilindja, Rruga Transballkanike, Pallati i Ri, Kati 2, Shk.1, e pajisur me Numër Unik Identifikimi (NUIS) M07013201T , me Administrator dhe Përfaqësues ligjor z. Zgjimi Caushaj, me pjesëmarrje në përqindje në kapitalin e kësaj shoqërie, Ortaket

BERNARD CAUSHAJ me 60 % TE KUOTAVE.

Sotir Veshaj me 20 % TE KUOTAVE.

Pandeli Veshaj 10 % TE KUOTAVE.

Zgjimi Caushaj 10 % TE KUOTAVE

Te gjithë bashke zotërojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit pjesëmarrje në përqindje në vlerën e kapitalit të shoqërisë ose kontribut në para = 10.000.00 (dhjete mijë) euro.

Neni 2. -Objekti i shitblerjes:

Me vullnetin e tyre të lirë, palët në këtë kontratë kanë rënë dakort sa më poshtë vijon:


2.1-**Z. Sotir Veshaj**, eshte dakort te shes 20 % te pjesemarrjen e kapitalin e shoqërisë me vlere 2.000 euro.

Z. Pandeli Veshaj , eshte dakort te shes 10 % te pjesemarrjen e kapitalin e shoqërisë me vlere 1.000 euro.

Z. Zgjimi Caushaj, eshte dakort te shes 10 % te pjesemarrjen e kapitalin e shoqërisë me vlere 1.000 euro (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë të Shoqërisë " DAKZ " Sh.p.k, në favor të Blerësit **BERNARD CAUSHAJ** i cili eshte dakord te bleje 40 % te kapitalit me vleren nominale **4.000 Euro**.

2.4-Vullneti i mësipërm i kësaj shitje, rezulton i shprehur dhe i mbështetur edhe në "Vendimin Nr. 12, dt. 14.04.2024 të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë " DAKZ" Sh.p.k, kopje e të cilit do t'i bashkëngjitet kësaj kontrate shitblerje dhe do të jetë pjesë përbërëse e saj.

Neni 3. -Çmimi i shitblerjes dhe mënyra e likuidimit:



Palët në këtë kontratë shitblerje deklarojne se vlera qe do te likujdohet nga Blerësi ne favor të Shitësit, eshte **në total = 4.000.00** (kater mijë) **euro**, të pjesëve **në total prej 40.00%** (dyzet perqind) të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë “DAKZ” Shpk.,

Neni 4. -Garancitë dhe të drejtat e palëve:

4.1-Shitësit e sigurojnë Blerësin se kuotat **në total prej 40.00%** (dyzetpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje të zotëruara nga Shitësit në vlerën e kapitalit të Shoqërisë “DAKZ” Sh.p.k ose kontribut në para në total = 4,000.00 (kater mijë) euro - objekt kontrate shitblerje, është e lirë nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore.

4.2-Shitesit i transferojnë Blerësit nëpërmjet kësaj kontrate shitblerje, pronësinë e plotë mbi pasurinë objekt kontrate shitblerje, e përbërë prej pjesës në total prej **100.00%** (njqindpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë “DAKZ” Sh.p.k ose kontribut në para në total = 10,000.00 (dhjetemije) Euro dhe me numër pjese 1, duke i njohur edhe te drejten e regjistrimit të kësaj kontrate shitblerje pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për pasqyrimin e kësaj shitblerje në favorin e tij në kollonat përkatëse të Regjistrimit Tregëtar.

4.3-Nëpërmjet kësaj kontrate shitblerje, Blerësi **BERNARD CAUSHAJ** bëhet zotërues i **100.00%** (njqindpërqind) të kuotave të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë “DAKZ” Shpk ose kontribut në para = **10,000.00 (dhjete mijë) euro** në kapitalin e Shoqërisë “DAKZ” Sh.p.k. Palet bien dakord se pagesa per cmimin eshte kryer, dhe nuk kane asnje pretendim.

Neni 5. -Anekset e kontratës:

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës:

-Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me Nr.12, datë 14.04.2024,

-Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Neni 6. -Baza ligjore:

-Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

-Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

Neni 7 -Dispozitat përfundimtare:

-Kontrata e Shitjes të kuotave.Per sa me siper, pasi u lexua dhe u gjete e rregullt Kontrata, u nenshkrua nga palet.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITESE:

Sotir Veshaj

Pandeli Veshaj

Zgjimi Caushaj

PALA BLERESE:

BERNARD CAUSHAJ

